

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 3226/Prot.
8

Patos më 06.09.2024.

PROCESVERBAL

MBI MIRATIMIN E RENDIT TË DITËS SË MBLEDHJES SË DATËS 30.08.2024

I mbajtur sot më datë 30.08.2024 në orën 11:00 në sallën e mbledhjeve të Këshillit ku zhvillohet mbledhja e Këshillit të Bashkisë:

Prezent në fillimin e mbledhjes këta këshilltare:

1. Vjollca Kasaj
2. Novrus Toska
3. Liljana Mesutaj
4. Elmira Rama
5. Gani Ahmetaj
6. Eduart Faslliaj
7. Erald Çepele
8. Albiona Lamaj
9. Ertilla Myrtaj
10. Klarida Semanjaku
11. Lori Musaj
12. Smerald Hazizaj
13. Renaldo Shpata
14. Artan Velçani
15. Armand Ahmetaj

Takimi hapet nga kryetari i Këshillit z. Armand Ahmetaj.
Armand Ahmetaj – Përhëndetje të nderuar koleg këshilltarë!
Të nderuar qytetarë!

Të nderuar specialistë të administratës!

Kjo është mbledhja e radhës e këshillit bashkiak.

Pjesëmarrja në mbledhje është 15 (pesëmbëdhjetë) këshilltarë, për momentin pasi është deklaruar një numër më i madh të cilin presim të vij.

Përpara se të kalojmë në leximin dhe miratimin e rendit të ditës dua t'ju them se kjo mbledhje është e bazuar në nenin 53 pika 4 të nenit 56 pika 2 të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore".

Rendi ditës është miratuar konform gjithë procedurave ligjore. Para se ta lexoj dua t'ju kërkoj që të diskutojmë mbi një pikë shtesë që është kërkuar nga ekzekutivi për ta futur në rendin e ditës i cili

të projekt-vendim “Për disa ndryshime në lidhjen nr. 3 dhe 4 të vendimit të Këshillit bashkiak nr. 74 datë 30.11.2023 “Mbi miratimin e nivelit të pagave të bashkisë, institucioneve në vartësi, Njësi Administrative, dhe funksioneve të transferuara për vitin 2024”. Pra është një projektvendim që ne e kemi diskutuar dhe në mbledhjen e kaluar edhe në komision por e kemi hequr për arsye se nuk ka pasur transferim fondi nga qeveria dhe e rikthejmë ta kalojmë sot, ka kaluar të gjitha procedurat, ka kaluar në komision dhe ka marrë votat unanime për t’ja kaluar këshillit për diskutim. Pra paraprakisht do doja që bashkarisht me këtë pikë:

Pika 1 është:

1- Miratimi i rendit të ditës.

2- Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Këshillit datë 18.07.2024.

3- Informacion mbi vendimet e miratuara në mbledhjen e datës 18.07.2024.

4- Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin Korrik 2024”.

5- Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin Korrik 2024”.

6- Projekt-vendim “Për miratimin e formatit të njoftim/punimeve që nuk kërkojnë pajisje me leje ndërtimi në zonat rurale”.

7- Diskutime të lira. Të cilën e kemi planifikuar meqënëse kemi patur kërkesën nga qytetarë për probleme të ndryshme e cila do të diskutohet në pikën e shtatë.

Dhe pika tetë është projektvendimi që sapo lexova.

Pjesëmarrja në sallë bëhet me 16 këshilltarë me ardhjen e z. Klaudio Alisininaj.

Armand Ahmetaj- Unë mendoj të kalojmë ne votim për miratimin e rendit të ditës. Kush është dakord?

Eduart Faslliaj- Kryetar unë kisha diçka, projektakti që ka ardhur dy ditë më përpara, kur na ka ardhur njoftimi sipas procedurës duhet të hidhet në votim më vete për ta futur në rendin e ditës. Nuk ka qënë në rendin paraprak. Rregullorja dhe ligji e parashikon që duhet të hyjë në rendin e ditës me 2/3 e votave.

Armand Ahmetaj- Nuk ka ndonjë ndryshim, kjo është pjesë përbërëse e rendit të ditës dhe nëse dikush nuk do ta votoj le ta shprehi që tani nuk është problem fare. Po unë besoj se kemi rënë dakord paraprakisht edhe në komision që ky do votohet se është votuar me shumicën edhe të komisionit por edhe Këshilltarët kanë marrë dijeni dhe kanë shprehur pothuajse qëndrimin e vet.

Eduart Faslliaj – Në fakt nuk thash këtë që ju sapo kthyet përgjigje. Ajo çfarë unë thash është që ne kemi pasur precedentë edhe në mbledhje të tjera. Për çdo pikë që hyn jashtë rendit paraprak të ditës për të cilin këshilltarët kanë marrë njoftimin bazuar mbi ligjin dhe rregulloren me të cilën kemi rënë dakord dhe që rrjedh nga ligji duhet të hyj me votimin e 2/3 të numrit të këshilltarëve dhe votohet me vete.

Armand Ahmetaj- Po pra jeni të lirë thash dhe unë ndaj e lexova. Nuk ka problem nese ju nuk jeni dakord ta fusni në rendin e ditës, unë prandaj e kërkoja bashkarisht me pikat e tjera. Ajo do të diskutohet në fund të mbledhjes si rregull.

Eduart Faslliaj- Në fakt ajo është e saktësuar. Një akt që hyn i ri jashtë rendit paraprak votohet më vete dhe do 2/3, rendi i ditës kërkon shumicë të thjeshtë. Kështu që duhet të votohet akti që ka hyr sipas ligjit dhe procedurës.

Armand Ahmetaj- Ti je dakord për këtë pikë që do shtojmë?

Eduart Faslliaj- Patjetër që jam dakord por ne nuk mund të dalim jashtë kornizës ligjore dhe jashtë rregullores.

Armand Ahmetaj- Ta thjeshtojmë gjënë.

Eduart Faslliaj – Jo mos ta thjeshtojmë ne e kemi pas precedentë, kështu kemi operuar dhe kjo do të bëhet precedentë gabim për herë të tjera. Çdo akt që hyn ligji thotë me 2/3 e votave.

Armand Ahmetaj- Tani unë dua të kujtoj se në rast se unë nuk ndesh kundërshtime të tilla nuk është e nevojshme që ne ta hedhim në votim të veçuar nga pikat e tjera. Besoj se jemi sqaruar, prandaj them ta votojmë rendin e ditës dhe të vazhdojmë.

Eduart Faslliaj- Thash unë jam pro por si procedurë duhet të votohet më vete.

Armand Ahmetaj- Kush është dakord me rendin e ditës duke përfshirë dhe këtë pikën?

Eduart Faslliaj- Jo kjo pikë miratohet me 2/3.

Armand Ahmetaj- E njehta gjë është.

Eduart Faslliaj- Nuk është e njehta gjë.

Armand Ahmetaj- Kush është dakord me rendin e ditës duke përfshirë dhe pikën që citova?

15 Pro

Eduart Faslliaj- Unë e dhash sqarimin tim, dhe thash je në shkelje të ligjit dhe procedurës.

Çdo akt që hyn i ri jashtë rendit paraprak miratohet me 2/3.

Armand Ahmetaj- të lutem tani 15 a jane 2/3.

Erald Çepele -14 janë 2/3.

Eduart Faslliaj- Po bëhet fjalë për rendin e ditës akti vohohet më vete pastaj miratohet rendi i ditës.

Armand Ahmetaj- ligjërisht unë ta lexova rendin e ditës të lexova dhe pikën shtesë. Përderisa këshilltarët nuk kanë kundërshtime, nuk shfaqin qëndrime kundër shtesës, nuk kemi pse zgjatemi tani të votojmë.

Eduart Faslliaj- Por ne jemi të detyruar të zbatojmë rregulloren për të cilën jemi dakorduar dhe që rrjedh nga ligji. Dhe ne kemi pas precedent të tjera kur kanë hyr pika të tjera në rendin e ditës jashtë rendit paraprak janë votuar me 2/3. Sot u dashka të bëhet në shkelje.

Armand Ahmetaj- I rikthehem procesverbalit dhe filmimeve dhe është po e njehta gjë që po bëjmë sot. Nuk ka asnjë ndryshim.

Eduart Faslliaj- Unë them që është kështu rregulli dhe ligji. Ti je në të drejtën tënde të bësh si të duash ashtu si jam unë në të drejtën time të apeloj pastaj.

Armand Ahmetaj- Faleminderit! Miratohet rendi i ditës me 15 pro. Votën tënde do ta shprehësh?

Eduart Faslliaj- E shpreha unë.

Armand Ahmetaj- Je pro, 16 pro.

Eduart Faslliaj- Jo pro, je duke proceduar në shkelje të ligjit. Akti duhet të hyj më vetë me 2/3.

Armand Ahmetaj- Faleminderit! Unë mendoj se nuk është kështu

Miratohet me 15 vota pro 1 kundër abstenim ska.


SEKRETARE

Refaela Xeba



KRYETAR

Armand Ahmetaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 3228/9 Prot.

Patos më 06.09.2024

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 30.08.2024 ora 11:00 , në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së dytë të rendit të ditës.

Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Këshillit datë 18.07.2024.

Armand Ahmetaj - Nëse ka ndonjë propozim, sygjërim për korrigjim procesverbali?

Nëse ska pyetje deklaroj miratimin e procesverbalit.

SEKRETARE
Refaela Xeba

Elmira Rama
Albiana Lomaj

Yjollca Lomaj

KRYETAR
Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 225/10 Prot.

Patos më, 06 09.2024

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 30.08.2024 ora 11:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së tretë të rendit të ditës.

Mbi informacionin për vendimet e miratuara në mbledhjen e datës 18.07.2024

Armand Ahmetaj- Fjala për Refaelën!

Refaela Xeba- Përshëndetje të gjithëve! Në mbledhjen e datës 18.07.2024 janë marrë gjithsej 4 vendime. Nga nr. 53 deri në nr 56.

Vendimet janë zbardhur në afat dhe i janë përcjell drejtorive përkatëse për ekzekutim.

Nga këto vendime vetëm vendimi nr. 55 dhe 56 shkoj në Prefekturë dhe me shpresën e datës 31.07.2024 ka ardhur përgjigja se vendimet janë në përputhje me ligjin.

Faleminderit!

Armand Ahmetaj- Faleminderit! Atëherë vazhdojmë me pikës katër.

SEKRETARE

Refaela Xeba

KRYETAR

Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 3222 Prot.

13

Patos më 06.09.2024.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 30.08.2024 ora 11:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së katërt të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin korrik 2024”.

Armand Ahmetaj- Ka kaluar në komisionin e Ekonomisë dhe është miratuar unanimitisht për tu kaluar këshillit për vendim. Nëse është e nevojshme thërrasim një specialist të bashkisë. Nëse dikush nga këshilltarët ka ndonjë pyetje shtesë?

Armand Ahmetaj –Atëherë meqënëse nuk kemi pyetje shtesë kalojmë në votim pikën e katërt. Atëherë kalojmë në votim. Kush është dakord për pikën e katërt? Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin korrik 2024”.

Miratohet me 15 vota pro, kundër ska, abstenim ska, një këshilltar prezent në sallë nuk merr pjesë në votim.

SEKRETARE
Refaela Xeba

KRYETAR
Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 3221 Prot.
/3

Patos më 06 09.2024.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 30.08.2024 ora 11:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së pestë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin korrik 2024”.

Armand Ahmetaj– Po e njejta gjë dhe për këtë pikë komisioni është mbledhur, e ka kaluar me votim unanimit për shqyrtim dhe vendim në këshillin bashkiak. Nëse keni pyetje e thërrasim përfaqësuesin e administratës bashkisë. Nëse nuk keni e kalojmë në votim

Armand Ahmetaj –S’kemi asnjë pyetje, atëherë e kalojmë në votim pikën e pestë projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin korrik 2024”.

Kush është dakord?

Miratohet me 15 vota pro, abstenim ska, 1 këshilltar prezent në sallë nuk merr pjesë në votim.

Shtohet prezenca me 1 këshilltarë znj. Enkelejda Ajazi. Prezenca 17 këshilltarë.

Largohet këshilltari z. Eduart Faslliaj. Prezenca 16 këshilltarë.

SEKRETARE

Refaela Xeba

KRYETAR

Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 3225/ Prot.
13

Patos më 06 .09.2024

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 30.08.2024 ora 11:00 , në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së gjashtë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për miratimin e formatit të njoftim/punimeve që nuk kërkojnë pajisje me leje ndërtimi në zonat rurale”.

Armand Ahmetaj- Ftojmë ekzekutivin.

Boreta Murati – Përshëndetje të gjithëve! Për projektvendimin “Për miratimin e formatit të njoftim/punimeve që nuk kërkojnë pajisje me leje ndërtimi në zonat rurale” do ti referohesha Vkm-së së re nr. 377, datë 12.6.2024 mbi disa ndryshime të zërave të punimeve që mund të ndërtojnë qytetarët në zonat rurale. Neni 6 liston gjithë ndërhyrje të brendshme apo të jashtme që kryhen me njoftim/vetdeklarim kryerjesh punimesh të cilat nuk kërkojnë pajisjen me leje ndërtimi dhe neni 6/1 që janë disa punime shtesë.

Në fakt unë do ta ndaja pak se ky formulari ka ardhur kryesisht vetëm për Njësitë Administrative dhe zonat rurale. Unë i kam përfshirë të gjitha punimet në një formular të vetëm për ta bërë të ndarë këtë nga pjesa urbane për faktin se vetdeklarimi përfshinë të gjitha ndërhyrjet siç janë rifiniturat, punim sistemimi, lysterje, freskim siç paraqiten dhe te neni 6. Ndërsa vendimi 377 i datës 12.6 përfshinë punime shtesë që përfshihen në këto zona dhe kryesisht janë këto punimet si:

- a. Riparimet e objekteve të regjistruara dhe çarjet në muret rrethuese, pa cënuar kalimet apo të drejtat e pronave kufitare;
- b. Vendosja e elementëve dekorativ. Është e nevojshme ti lexoj të gjitha?

Këshilli -Jo

Janë disa punime shtesë të cilat kërkojnë dhe dokumenta shtesë që ligji i ka përcaktuar në bazë të nenit 6.2 që përfshihet dokumentacioni i pronësisë por pak më i thjeshtuar. Në qoftë se më përpara ne për ndërtimin e mureve mbajtës ose mureve rrethues kërkonim dokument pronësie (certifikat pronësie) në fakt edhe në këtë rast ne do të kërkojmë dokument pronësie por do jetë më pak e thjeshtuar nëse ai do të ketë një leje lëgalizimi dhe nëse ai mund të bëjë një rilevim topografik ose një planvendosje sipas ligjit të përcaktuar. Gjithashtu është një deklaratë e subjektit që ai merr përsipër që çdo dokumentacion që paraqet pranë autoritetit vendor mban përgjegjësi po ashtu dhe për punimet që ai do të kryej.

Rilevimi topografik dhe planvendosja janë dy dokumenta të cilat mund të jenë opsionale, duke qënë se ligji e përcakton se mund ta bëjë dhe nga një topograf i licensuar ose mund ti bëjë nga autoriteti vendor. Ne mendojmë se për këto dy shërbime të ofrohen me pagesë. Po ashtu do kemi dhe fotografitë siç përfshihen aktualisht tek vetdeklarimi dhe dokumenta shtesë që kërkohen nga autoriteti vendor. Ideja e këtij formulari është të jetë vetëm një që të përfshijë çdo punim si tek mirëmbajtja e zakonshme po ashtu dhe punimet shtesë sipas vendimit dhe ky duhet të jetë i ndryshëm nga vetdeklarimi që do ketë dhe tarifën. **Por duke qënë se ne jemi në faktin duke hartuar paketën fiskale në lidhje me këto punime do të aplikohet një tarifë e njejtë me atë që është miratuar në paketën fiskale që është gati pesë mijë lekë të reja dhe në paketën e re fiskale që ne jemi duke e punuar akoma do trajtohen të gjitha tarifën siç është për subjektet,**

për individët, për planvendosjen, si dhe për planin e rievimit. Siç e theksova dhe më përpara këto dy shërbime do jenë opsionale. Ne kërkojmë nga këshilli i bashkisë që:

1. Të miratoj formularin e njoftimit/punimeve për ndërhyrjet në zonat rurale, pjesë përbërëse të këtij projekt-vendimi.

Gjithashtu deri në miratimin e paketës fiskale që bëhet në muajtë në vazhdim duam që këto tarifa të miratohen sipas paketës së vjetër dhe të shtohen më vonë pas dëgjësave publike. Nuk është e përcaktuar në projektvendim por do doja që të reflektohej në vendimin e këshillit dhe në procesverbalin që mbahet.

Armand Ahmetaj- Pra materiali që ju keni nuk e ka të përcaktuar pikën që sapo citoj Bora dhe kërkohet që në fund bashkë më këtë pikë të miratohet në tërësi vendimi.

Erald Çepele- Ajo që shikoj unë këtu te kjo pjesë nuk ka asnjë gjë bile mos ka më pak se vendimi 408 dhe konkretisht pika 6 ndërhyrjet që nuk kërkojnë pajisje me leje ndërtimi. Dhe këtu kanë qënë më tepër pika sesa pika që ne po miratojmë sot. Kurse ato që janë neni 7 dhe ka punimet që kryhen me deklaratë paraprake i ka shume qartë dhe janë pothuajse të njejtat gjera nuk e di se ca ka ndonjë ndryshim. Dua një sqarim kush është shtuar këtu ose çfarë është hequr?

Boreta Murati- Neni 6 përfshin ndërhyrje të zakonshme, neni 7 kalon në deklaratë paraprake. Neni 6.1 përfshin punimet shtesë të vendimit 377 siç janë muret mbajtës, ndërtimi i cativë të pashfytëzueshme, serat e çmontueshme dhe të tjera siç janë të përfshira. Në pjesën e parë të formatit janë të përfshira punimet e nenit 6.1.

Sipas vendimit të ri del që në zonat rurale mund të ndërtohen çati të pashfytëzueshme. Ndërsa neni 6 dhe siç ne e kemi përcaktuar tek pika e dytë që ka dhe ndryshim në dokumentacion është po e njejtja gjë me vetdeklarimin por është një format i përbashkët për zonën rurale. Domethënë për fshatrat e Njësisë Administrative Patos dhe për Njësitë Administrative.

Erald Çepele- Tek ky formulari unë nuk shikoj, thotë ndërtime mure rrethues pa bazament betoni që do të thotë vetëm me tel ose rrjet mund të thurin.

Boreta Murati- Është tek neni 6 ndërsa neni 6.1 ta lejon pasi ka një dokumentacion shtesë që do të thotë ne qoftë se ti do të bësh një rrethim parcele, trualli atëhere do të bësh një plan rievimi dhe një planvendosje të përcaktuar që të tregojnë ty kufijtë e pronës ndërsa me nenin 6 i ke dokumentacion më të reduktuar.

Erald Çepele- Jemi në kushtet që leja e legalizimit të zgjidh vetëm çështjen e pronësisë së objektit dhe ti nuk e ke zgjidhur çështjen e pronës. Mund të ketë problem me kufitarët, me azhornimin, nuk e ke tokën në emrin tënd. Si do të veprohet në këto raste?

Boreta Murati- Për sa kohë ka një dokument pronësie prsh ka një amtp që vërteton që pronësia është në emër të këtij është më e thjeshtësuar. Janë marrëveshjet që bëjnë qytetarët me njëri tjetrin, është dhe kryeplaku i fshatit që jep dhe vërtetim që kjo prona është e dikujt apo është e zaptuar nga dikush.

Çdo leje jepet në bazë të dokumentit të pronësisë. Nëse asnjë ska asnjë dokument pronësie as ne nuk kemi si të japim leje pa e vërtetuar që ajo pronë është në pronësinë e dikujt.

Albiona Lamaj- Çfarë nënkupton zona rurale? Ne mund të themi Ruzhdië dhe Zharrëz apo përfshin dhe zonën periferike të Patosit?

Boreta Murati – Janë të ndara sipas ligjit në mos gaboj 115/2014 për ndarjen administrative territoriale të Njësisë së vetëqeverisjes vendore. Aty është e përcaktuar zona e fshatrave të njësisë administrative Patos, po ashtu dhe Njësitë Administrative Patos dhe Zharrëz. Qyteti përfshin zonën kadastrale 2890 për të cilën vazhdojnë kërkesat për leje, vetëdeklarim për punime të mirmbajtjes së zakonshme dhe kërkesa për punime të tjera shtesë sipas neneve përkatëse.

Albiona Lamaj- Dhe diçka tjetër edhe pse kjo do parë dhe te paketa fiskale e re që do bëhet. Çështja është sepse ka ndodhur shpesh edhe nga qytetarët që ajo pagesa që mund të paguajnë ata mund të jetë më shumë se punime që mund të bëjnë. Ndonjëherë ajo duhet parë se nëse unë bëj shumë punime duhet të paguaj më shumë se nëse bëj më pak. Jo të jëtë e njejtë për të gjithë. Kjo duhet parë si sygjërim.

Boreta Murati- Pagesat janë vendosur fikse që ne në çdo kërkesë për leje të bëjmë një kosto. Të llogarisim koston e punimeve që të përcaktojmë një vlerë. Kështu që gjithë tarifat janë fikse. Prandaj them që njoftimi i punimeve meqënëse ka punime shitesë që nuk janë punime të mirëmbajtjes së zakonshme përfshihen edhe këto, janë punime mirëmbajtës, mur rrethues ose ndertimi i çatave të pashfrytëzueshme kanë një kosto më të lartë sesa punimet e mirëmbajtjes së zakonshme.

Albiona Lmaj- Do kenë të njejtën pagesë?

Boreta Murati- Jo nuk do kenë të njejtën pagesë por duke qënë se ne jemi duke punuar për paketën fiskale dhe do kalojmë procesin e dëgjësive publike do bëhet pak më vonë. Për momentin ne mendojmë që ta lëmë me të njejtat tarifa që mos të pengojmë qytetarët që bëjnë kërkesa çdo ditë për punime që kryejnë.

Erald Çepele- Çfarë është parashikuar ndihmesë nga ana e admisnistratës duke qënë se pjesa që jeton në zona rurale janë pjesë vunerabël nuk kanë mundësi, ndonjëherë inxhinieri kërkon më shumë se sa vlera e projektit. Këtu duhet të nderhyjmë më ndonjë planvendosje, të paktën nga ana e drejtorisë e shërbimeve.

Boreta Murati- Në këtë rast me njoftimin fillimit të punimeve nuk ka projekt, prandaj është më e lehtësuar

Armand Ahmetaj- Bora planvendosjen do ta bëj bashkia?

Boreta Murati- është në kërkesë të qytetarit. Nëqoftëse qytetari do që ta bëj bashkia do paguaj tarifën e përcaktuar po ashtu dhe tek planrilevimi.

Armand Ahmetaj- sa do jetë tarifa?

Boreta Murati- Tarifa për palnvendosjen është e përcaktuar në paketën fiskale e cila është 2 mijë lekë të reja ndërsa për planrilevimi nuk e kemi përcaktuar akoma. Planrilevimi është një dokument i cili përcakton kufijtë e pronës dhe ky bëhet nga një topograf i licensuar. Bashkia do ta ofroj si shërbim por kjo do kaloj në paktetën e re fiskale dhe do këtë një kosto më të ulët se ajo që ofrohet nga subjektet e licensuar



Armand Ahmetaj – Kemi ndonjë diskutim tjetër ? Nëse nuk keni unë propozoj ta kalojmë në votim pikën e gjashtë Projekt-vendim “Për miratimin e formatit të njoftim/punimeve që nuk kërkojnë pajisje me leje ndërtimi në zonat rurale”.

Kush është dakord?

Kundër ska, abstenim ska, miratohet me 16 vota pro.


SEKRETARE

Refaela Xeba



KRYETAR

Armand Ahmetaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 3220 Prot.

Patos më 06.09.2024.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 30.08.2024 ora 11:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së shtatë të rendit të ditës.

Diskutime të tjera

Armand Ahmetaj- E kemi vendosur jo pa qëllim këtë pikë. Ka një kërkesë të qytetart Veip Kamberaj që unë dua ta falenderoj, e kemi dhe mbledhje sot. Ka të bëjë me një shqetësim që sjellin qentë endacakë në qytet. Këtë ja kemi adresuar zyrës përgjegjëse në admnistratë e cila ka dhe një përgjigje e cila është zyra e bujqësisë dhe mjedisit.

Orges Gollosi- Shërbimi veteriner ka qënë i atashuar pranë institucionit të bashkisë me ligjin nr. 10 465, ku janë përcaktuar funksionet pranë njësisë kryesisht funksionet bazë për monitorimin e thertoreve dhe me radhë. Në vitin 2020 me vkm 683 ky shërbim kalon pranë autoritetit kombëtar të veterinarisë dhe mbrojtjes së bimëve. Që do të thotë monitorimi i geneve endacakë dhe kafshëve të tjera bëhet nga inspektorët e Agjencisë Rajonale të Vëtërinarisë së Mbrojtjes e cila është në Vlorë. Normalisht mirëqënia dhe shërbimi ndaj qytetarëve është prioritet i bashkisë i kemi marrë ankesat dhe shqetësimet që të gjitha dhe kemi dhënë dhe propozuar zgjidhje që janë në vazhdimësi. Zgjidhja e tanishme është (besoj se ka ndryshim në qytet) që kemi orientuar largimin e tyre me ndihmën e ndarrrmarjes vartëse drejt zonave të pabanuara të territorit të bashkisë Patos. Zgjidhje ligjore dhe e pranushme. Megjithatë jemi në kontakt të vazhdueshëm dhe me sektorin e integritimit në rast se shoqëritë civile apo organizatat arrijnë të sjellin një projekt për rehabilitimin e këtyre jemi të gatshëm dhe ti ofrojmë të gjithë asistencën tonë. Sepse krijimi i një projekti nga ana e bashkisë për momentin është e pamundur.

ZV/kryetare e bashkisë Ina Sauli- Gjithsesi e kemi vlersuar si ankesë dhe do ti japim një zgjidhje.

Veip Kamberaj- Shpreh problematiken e qenëve endacak në qytet si dhe falenderon Bashkinë për marrjen e masave pas kërkesës.

Këshillit Bashkiak ti paraqitet ajo kërkesë.

Armand Ahmetaj- Është njohur këshilli bashkiak me atë kërkesë. Përpara se të futet në rendin e ditës por qentë endacakë dihet çfarë problemi sjellin, jo pa qëllim kemi dhe specialistët që të sqarojnë. Ke ndonjë gjë tjetër së këshilltarët janë njohur me kërkesën.

Veip Kamberaj- Nuk e di këshilltarët të diskutojnë.

Armand Ahmetaj- Është diçka që ne e shohim, është i përditshëm . Nuk ndodh vetëm këtu.

Veip Kamberaj- Mirë do ishte të merreshin masa.

Armand Ahmetaj- Mesa ka parë është pakësuar numri i geneve endacakë.

Veip Kamberaj- Po e kam vënë re.

Novrus Toska- Doja të thoja një shqetësim që më ka ardhur para dy ditësh që ka të bëjë me burimin ujqor të përroit të Zharrzës. Përroi që furnizon me ujë përroit e Zharrës dhe bëhet fjalë për përroit e

buallit i cili vjen nga zonat mbi territoret tona dhe që bashkia Roskovec ka bërë investime dhe ka bërë ndërhyrje për devijimin e këtyre burimeve ujore. Di gjë Bashkia për këtë problem? Kërkoj që për këtë të informohet këshilli, të vihet administrata e bashkisë në lëvizje. Mendoj se do gjej rrugë zgjidhje në shtetin shqipëtar nëqoftë se do të ndërhyhet për këtë problem. Ai ujë duhet të kaloj atje ku ka kaluar. Për burimet ujore ka paskur kontradita dhe shteti ynë me shtete të tjera. Orgest Gollosi- Informacion zyrtar nuk kishim për këtë ndërhyrje po megjithatë menaxhimi dhe monitorimi i skemave vaditëse që përfshin më shumë se një territor bashkie bëhet nga Drejtoria Rajonale e Ujitje Kullimit Fier, ne kemi qënë në vazhdimësi në bashkëpunim me ta dhe për rastin në fjalë do jemi në kontakt të vazhdueshëm zyrtar që të marim informacionet e duhura. Armand Ahmetaj- Faleminderit!

SEKRETARE

Refaela Xeba




Elmira Romo
Albina Romo
Gjollca Kasej

KRYETAR

Armand Ahmetaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 3295 Prot.

13

Patos më 06.09.2024.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 30.08.2024 ora 11:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së tetë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për disa ndryshime në lidhjen nr. 3 dhe 4 të vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 74 datë 30.11.2023 “Mbi miratimin e nivelit të pagave të bashkisë, institucioneve në vartësi, Njësive Administrative, dhe funksioneve të transferuara për vitin 2024”.

Juela Shpata- Përshëndetje të gjithëve! Sot paraqesim përpara jush Projekt-vendim “Për disa ndryshime në lidhjen nr. 3 dhe 4 të vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 74 datë 30.11.2023 “Mbi miratimin e nivelit të pagave të bashkisë, institucioneve në vartësi, Njësive Administrative, dhe funksioneve të transferuara për vitin 2024”. Konkretisht lidhja 3 dhe 4 kanë të bëjnë me ndryshimin e nivelit të pagave për punonjësit mesimorë dhe jomësimorë dhe për punonjësit e MZSH-së. Bashkëlidhur projektvendimit është dhe shtesa e fondit e cila ka ardhur nga qeveria. Niveli i pagës së punonjësve mesimorë dhe jomësimorë dhe mbështetës është në nivele maksimal. Bashkëlidhur pak më parë njëri nga anëtarët e këshillit më kërkoj dhe tabelën. Nga juaj kërkoj miratimin e projektvendimit.

Erald Çepele- Janë tre emertesa zjarrëfikës me paga të ndryshme. Janë sipas kategorive?

Juela Shpata- Të tre emërtimet zjarrëfikës që janë bashkëlidhur kanë dhe gradat. Ata gradohen asistent zjarrëfikës që është niveli i parë zjarrëfikës dhe kryezjarrëfikës te kolona e tretë.

Elmira Rama- Në lidhje me rritjen e pagës tek funksionet mbështetës shikoj vetëm 1%, është vetëm maksimalja? Është e pamundur më shumë se paska një diferencë goxha ?

Juela Shpata – Punonjësit mbështetës janë sekretare e shkollës, kuzhinier ndihmës kuzhinier, sanitare dhe roje. Sanitarja dhe roja kanë pasur gjithmonë pagën minimale. Në VKM është përcaktuar 4 mijë lekë të rëja mbi pagën e pozicionit. Kjo është maksimalja.

Armand Ahmetaj-Kush është dakord?

Kalojmë në votimin e pikës së tetë Projekt-vendim “Për disa ndryshime në lidhjen nr. 3 dhe 4 të vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 74 datë 30.11.2023 “Mbi miratimin e nivelit të pagave të bashkisë, institucioneve në vartësi, Njësive Administrative, dhe funksioneve të transferuara për vitin 2024”.

Kush është dakord?

Kundër ska, abstenim ska, miratohet me 15 vota pro. Pasi është larguar këshilltari Artan Velçani.

SEKRETARE

Refaela Xeba

Elmira Rama

KRYETAR

Armand Ahmetaj

Yolca Jashaj

Albion Gjomaj

Armand Ahmetaj